

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me sekretaren juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.B. nga fshati H., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.4234/2016 të dt.07.09.2016, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor publik të mbajtur me datë 23.03.2017, në praninë e përfaqësuesit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Ibrahim Fejza, të akuzuarit dhe përfaqësuesit të dëmtuarës F.R., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 19.04.2017, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M.B., me nofkën C., nga i ati A. dhe nëna E., e vajzërisë P., i lindur më *data e lindjes...*, në fshatin H., Komuna e P., ku edhe tani jeton, me nr. personal: *numri personal...*, ka të kryer shkollën e mesme teknike, saldues, i gjendjes së dobët ekonomiko-sociale, i martuar, baba i 3 (tre) fëmijëve, ka qenë i gjykuar edhe më parë për vepër të njëjtë penale dhe ndaj tij zhvillohet edhe procedurë tjetër penale, Shqiptar - Kosovar, Shtetas i Republikës së Kosovës,

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

Me dt. 15.07.2016, rreth orës 15:00, në regjionin ekonomiko pyjor të fshatit Sh., Komuna P., në vendin e quajtur "...", me qëllim të vjedhjes në pyll, i pandehuri ka prerë 60 copë trungje, të llojit ahu dhe shkoze, me diametër 18-20 cm, të gjata 13-14 m, dhe vëllim të përgjithshëm prej 4 m³, me ç'rast të dëmtuarës Agjensia Pyjore e Kosovës, i ka shkaktuar dëm material,-

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe neni 358 par.1 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e

G J Y K O N

I. Të akuzuarin **M.(A.) B.**, me **dënim me kusht**, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **tre (3) muajsh**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri **në afat prej 1 (një) viti** nuk kryen vepër të re penale.

II. **Detyrohet** i pandehuri që në emër të shpenzimeve paushalle të paguajë shumë prej **50€ (pesëdhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III. E dëmtuara Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - KK. P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.4234/2016 të dt.07.09.2016, kundër të akuzuarit M.B. nga fshati H., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt. 20.03.2017 dhe 23.03.2017, gjatë së cilës u dëgjuan Prokurori i Shtetit - Ibrahim Fejza nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i akuzuari M.B., përfaqësuesi i të dëmtuarës F.R. dhe dëshmitari – roja e pyllit N.J.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor i akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht, me liri të plotë nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori shtetit.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit, marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit dhe përfaqësuesit të dëmtuarës, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërtetoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPPRK-së dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor, andaj Gjykata konform nenit 326 par.4 të KPPRK-së, ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se bazuar në deklarin e sotëm të dhënë nga roja e pyllit, e precizoi dispozitivin e aktakuzës, ashtu që numri i drunjëve duhet të jetë 60 copë, me diametër 18-20cm, të gjata 13-14m, dhe vëllim të përgjithshëm prej 4m³, derisa i pandehuri ka shkaktuar dëm material, po ashtu bazuar në faktin se i pandehuri deklaroi se e pranon faktin se në ditën kritike e ka takuar pylltarin dhe ka kontaktuar me të, dhe se ka qenë me traktor dhe ka marrë dru, nga e gjithë kjo deklarojmë se mbetemi pran kësaj aktakuze, ndërsa nga gjykata kërkohet që ndaj të pandehurit të veproj sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohem me fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ndërsa parashtroj kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e pranon fajësinë, kërkoi nga gjykata një dënim sa më të butë se jam i papunë, i gjendjes së rëndë ekonomike, i premtoj gjykatës se më nuk do ta përsërisë veprën penale.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet i akuzuari, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penalo-juridik është përgjegjës, e për këtë edhe e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, si dhe gjendjen e rëndë ekonomike, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka qenë edhe më parë i gjykuar për vepër të njëjtë penale, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 par.1 dhe par.2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 dhe par.3 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizim të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil, u morë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata nuk pati ekspertizë nga ndonjë institucion i pavarur, në mënyrë që gjykata të vërtetoj saktësisht dëmin e shkaktuar, ashtu që dëmi i vlerësuar vetëm nga pala e dëmtuar nuk paraqet bazë të sigurt për gjykim, andaj gjykata nuk e pranoj dhe mbi këtë bazë është udhëzuar në kontest civil.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.961/2016, më dt. 19.04.2017

Sekretare juridike,
Mihrie Krasniqi-Sheholli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Gazmend Bahtiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.